



Shërbimi i Zjarrfikës dhe Shpëtimit, Prizren



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Drejtoria e Shërbimeve Publike
Direktorijat za Javne Usluge
Kamu Hizmetler Müdürlüğü



11 217/49254 17/04/14
KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë - Gjakovë

Kolegji BIZNESI

11 Nr. 217 Prot

Nr. 107/14 Prot

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ky memorandum lidhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

Kolegjit "Biznesi", që është institucion privat i arsimit të lartë, i akredituar nga "Agjencia Kosovare e Akreditimit" dhe i licencuar nga "Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë", që ka si objektiv të sigurojë veprimtari arsimore dhe shkencore, kultivimin e dijes dhe shkencës, mbështetjen e shoqërisë në aspektin ekonomik dhe social, si dhe afirmimin e vlerave kombëtare dhe evropiane.

Sherbimi i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit Prizren, institucion në Komunen e Prizrenit.

Palët bien dakort të respektojnë qëllimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

- Ofrimi i mundësisë së studentëve të kolegjit BIZNESI, programi "Teknik i Mbrojtjes nga Zjarri", në realizimin e pjesës praktike në këtë institucion.

- Shfrytëzimin e pajisjeve dhe poligonit praktik të Sherbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Prizren.

Bashkpunim me zjarrfiksit rofesional per realizmin e pjese praktike te programeve trajnuese te Kolegjit Biznesi.

Neni 2 Objekti

- Të dyja institucionet deklarojnë se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi me qëllim të aftësimit të studentëve.

Neni 3 Komunikimi

Palët do të caktojnë persona kontakti që do të jenë përgjegjës për zbatimin e Memorandumit, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm. Në rastet e shmangies nga procedurat e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4 Ndryshime

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të palëve.

Neni 5 Përfundimi i Memorandumit

Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër.

Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa i përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara dates së përfundimit të tij.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave Komunen e Prizrenit dhe dy të tjera në Kolegjin "Biznesi"

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, me datë 16 Prill 2014.

për
PËR KOLEGJIN "BIZNESI"
Prof. Dr. Shyqeri Kabashi



PËR KOMUNEN E Prizrenit
Drejtore e Emergjencave
Bedrija Ejupagić

A handwritten signature in black ink, appearing to be "Bedrija Ejupagić".

